# FLETORJA ZYRTARE

# E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

| Nr. 87 | 2003 | Tetor |
|---|---|---|


PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Udhëzim i KQZ nr.9, datë 20.9.2003 | Mbi procedurën e numërimit të votive dhe administrimin e fletëve të votimit nga komisioni i qëndrës së votimit | 3835 |
| Udhëzim i KQZ nr.10, datë 27.9.2003 | Për rregullat që duhen respektuar për afishimin e materialeve propagandistike | 3842 |
| Udhëzim i KQZ nr.11, datë 29.9.2003 | Për mënyrën e administrimit të listës së zgjedhësve që përdor KQV-ja ditën e votimit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2003 | 3843 |
| Udhëzim i KQZ nr.12, datë 30.9.2003 | Mbi mënyrën e administrimit të tabelave të rezultateve të qendrave të votimit nga komisioni zgjedhor i qeverisjes vendore | 3844 |
| Udhëzim i KQZ nr.13, datë 3.10.2003 | Për shpërndarjen dhe përdorimin e fletëve të votimit nga KQV | 3845 |
| Udhëzim i KQZ nr.14, datë 5.10.2003 | Për miratimin e detyrave të Policisë së Shtetit dhe forcave të ushtrisë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2003 | 3845 |
| Udhëzim i KQZ nr.15, datë 9.10.2003 | Mbi procedurën e rinumërimit të votave | 3848 |

| | | |
|---|---|---|
| Udhëzim i KQZ nr.16, datë 10.10.2003 | Mbi procedurën e votimit të zgjedhësve të | 3852 |
| Udhezim i KQZ nr.17, datë 10.10.2003 | Për regjistrimin e zgjedhësve që votojn me vendim gjykate | 3853 |
| Udhëzim i KQZ nr.18, datën 11.10.2003 | Për një ndryshim në udhëzimin e KQZ-së nr.9, datë 20.9.2003 "Mbi procedurat e numërimit të votave dhe administrimin e fletëve të votimit nga komisioni i qëndrës së votimit" | 3854 |
| Vendim i Bankës së Shqipërisë nr.78, datë 17.9.2003 | Për një ndryshim në udhëzimin "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.43, datë 11.6.2003 | 3854 |
| Udhëzim i Bankës së Shqipërisë | Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka | 3855 |
| | Shpallje kërkese për shpronësim me objekt shpronësimin publik të pasurive të pasurive të paluajtshme për ndërtimin e Aeroportit të Kukësit dhe të rrugëve të reja | 3858 |

**UDHËZIM**
**Nr.9, datë 20.9.2003**

# MBI PROCEDURËN E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE ADMINISTRIMIN E FLETËVE TË VOTIMIT NGA KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 29 pika 1, nenin 47, 91 dhe 109 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

UDHËZON:

## PJESA I
## QËLLIMI DHE PËRKUFIZIME

### Neni 1
### Qëllimi

Ky udhëzim jep përkufizimet lidhur me vlerësimin e fletëve të votimit, përcakton procedurat që duhet të ndiqen nga komisioni i qendrës së votimit para dhe pas hapjes të kutisë së votimit për numërimin e fletëve të votimit dhe votave për kandidatët për kryetar bashkie a komune, si dhe për partitë a koalicionet dhe kandidatët e pavarur, që kanë paraqitur lista shumemërore për këshillat e bashkive a komunave, si dhe rregullon mënyrën e administrimit të fletëve të votimit, në zarfe të veçantë në përfundim të numërimit.

### Neni 2
### Zgjedhësit që kanë votuar

Zgjedhësit, që kanë votuar në një qendër votimi, janë ata zgjedhës të cilët janë paraqitur në qendrën e votimit, kanë firmosur përbri emrit të tyre në listën e zgjedhësve dhe kanë ushtruar të drejtën e votës.

### Neni 3
### Fletëvotimi të papërdorura

Fletëvotimi të papërdorura, janë ato fletëvotimi, të cilat në përfundim të procesit të votimit gjenden jashtë kutisë së votimit, të pashkëputura nga kundërfletët me numër serie.

### Neni 4
### Kundërfleta e fletës së votimit

Kundërfleta e fletës së votimit është pjesa e sipërme (pa ngjyrë) e fletës së votimit, në të cilën është shënuar edhe numri serial i fletës së votimit. Fleta e votimit është e shkëputshme nga kundërfleta e saj.

### Neni 5
### Fletëvotimi të përdorura

Fletët e votimit të përdorura përfaqësojnë tërësinë e fletëve të votimit, të cilat në përfundim të procesit të votimit gjenden brenda dhe jashtë kutisë së votimit, të shkëputura nga kundërfletët me numër serie.

### Neni 6
### Fletëvotimi të dëmtuara

Fletëvotimi të dëmtuara janë ato fletëvotimi:

a) që janë të grisura;

b) shënimet janë bërë jashtë dhomës së fshehtë.

Në përfundim të procesit të votimit këto fletëvotimi gjenden jashtë kutisë së votimit, të shkëputura nga kundërfletët me numër serie.

Neni 7

**Fletëvotimi të gjetura në kutinë e votimit**

Fletëvotimi, të gjetura në kutinë e votimit, janë fletët e votimit të nxjerra nga kutia e votimit pas hapjes së saj. Fletët e votimit të gjetura në kutinë e votimit vlerësohen nga Komisioni i qendrës së votimit për nxjerrjen e rezultatit të votimit.

Neni 8

**Fletëvotimi të parregullta**

a. Fletëvotimi të parregullta janë ato fletëvotimi të cilat:

i) nuk kanë të njëjtën madhësi, ngjyrë apo formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja;

ii) nuk kanë në pjesën e pasme firmën e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të KQV-së;

iii) nuk kanë në pjesën e pasme vulën e KQV-së;

iv) kanë në pjesën e fletës së votimit shënime, që mund të zbulojnë identitetin e zgjedhësit;

v) kanë në pjesën e fletës së votimit shënime në favor apo disfavor të subjekteve zgjedhore.

b. Të gjitha fletët e tjera të votimit janë fletë të rregullta.

Neni 9

**Vota të pavlefshme**

a. Vota është e pavlefshme për kandidatët:

i) kur në pjesën e fletës së votimit, për kandidatët është votuar për më shumë se një kandidat;

ii) kur në pjesën e fletës së votimit, për kandidatët nuk është votuar për asnjë kandidat;

iii) kur nuk është e qartë se për cilin nga kandidatët ka votuar zgjedhësi;

iv) kur zgjedhësi ka votuar për një person që nuk është në fletën e votimit.

b. Votat janë të pavlefshme për partitë a koalicionet:

i) kur në pjesën e fletës së votimit, për partitë a koalicionet, është votuar për më shumë se një parti ose koalicion;

ii) kur në pjesën e fletës së votimit, për parti a koalicion, nuk është votuar për asnjë parti a koalicion;

iii) kur nuk është e qartë se për cilën nga partitë a koalicionet ka votuar zgjedhësi;

iv) kur zgjedhësi ka votuar për një parti a koalicion, që nuk është në fletën e votimit.

c. Të gjitha votat e tjera janë vota të vlefshme.

Neni 10

**Fletëvotimi të kontestuara**

Fletëvotimi të kontestuara janë të gjitha ato fletëvotimi të vlerësuara nga komisioni i qendrës së votimit, por që kontestohen nga të paktën një anëtar i Komisionit apo të paktën një përfaqësues i një subjekti zgjedhor.

Fletët e votimit të kontestuara administrohen nga KQV-ja sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 11

**Vendimmarrja**

Komisioni i qendrës së votimit vlerëson fletët e votimit me konsensus. Në rastet kur nuk

arrihet konsensus vlerësimi bëhet me votim. Vendimet e ndërmjetme për vlerësimin e fletës së votimit merren kur të paktën pesë anëtarë të KQV-së votojnë “PRO”.

## PJESA II
## PROCEDURAT PARA HAPJES SË KUTISË SË VOTIMIT

### Neni 12
### Numri i zgjedhësve që kanë votuar

Me përfundimin e procesit të votimit, kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit fillojnë procedurat për numërimin e fletëve të votimit dhe nxjerrjen e rezultatit. Fillimisht përcaktojnë numrin e zgjedhësve që kanë votuar në atë qendër votimi, duke numëruar firmat e vendosura nga zgjedhësit në listën përkatëse të zgjedhësve dhe e regjistrojnë atë në fletoren e procesverbalit të QV-së.

### Neni 13
### Numri i fletëve të votimit të përdorura

Kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit përcaktojnë numrin e fletëve të votimit, të përdorura në bazë të numrit të serisë të kundërfletëve nga të cilat janë shkëputur fletët e votimit dhe e shënojnë atë në fletoren e procesverbalit të QV-së.

### Neni 14
### Numri i fletëve të votimit të papërdorura

Kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit përcaktojnë numrin e fletëve të votimit të papërdoruara, në bazë të numrit serial të kundërfletëve dhe e shënojnë atë në fletoren e procesverbalit të QV-së.

### Neni 15
### Numri i fletëve të votimit të dëmtuara

Kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit përcaktojnë numrin e fletëve të votimit të dëmtuara, duke i numëruar ato.

### Neni 16
### Verifikimi i fletëve të votimit të përdorura

a) Kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit zbresin nga numri i fletëve të votimit të përdorura, numrin e fletëve të votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbalin e qendrës së votimit. Ky numër duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve, që kanë votuar sipas listës së zgjedhësve.

b) Në rast se ky numër nuk del i barabartë me numrin e zgjedhësve që kanë votuar, atëherë kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit verifikojnë edhe njëherë veprimet e kryera sipas përcaktimeve në nenet 12, 13, 14 dhe 15. Rezultati shënohet në procesverbal i shoqëruar me arsyetimin e KQV-së për këtë fakt.

### Neni 17
### Vulat e kutisë së votimit

Kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit verifikojnë nëse vulat e kutisë së votimit kanë të njëjtat kode me ato të shënuara në fletoren e procesverbalit të QV-së, para fillimit të procesit të votimit. Nëse kodet nuk janë të njëjta, përpara se të hapë kutinë e votimit KQV shënon në procesverbal këtë fakt dhe numrat e kodeve të vulave. KQV-ja njofton menjëherë KZQV-në dhe më pas fillon procedurën për hapjen e kutisë së votimit dhe vlerësimin e votave.

## PJESA III
## PROCEDURAT PAS HAPJES SË KUTISË SË VOTIMIT

### Neni 18

Pas verifikimit të kodeve, KQV-ja hap kutinë e votimit dhe nxjerr mbi tavolinën e punës të gjitha fletët e votimit që ndodhen brenda.

### Neni 19
### **Numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti**

Kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit numërojnë fletët e votimit të nxjerra nga kutia e votimit, shënojnë numrin në fletoren e procesverbalit të QV-së dhe verifikojnë nëse ky numër është i njëjtë me numrin e zgjedhësve, që kanë votuar sipas listës së zgjedhësve. Nëse, ky numër nuk është i njëjtë, KQV-ja vlerëson arsyet e diferencës edhe në bazë të numrit të fletëve të dëmtuara. Ky fakt regjistrohet në procesverbalin e QV-së, si dhe evidentohet qartë në tabelën e rezultateve të qendrës së votimit.

### Neni 20
### **Vlerësimi i fletëve të votimit të rregullta dhe të parregullta**

Kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit vlerësojnë fletët e votimit të rregullta dhe të parregullta.

a) Gjatë kësaj procedure KQV-ja ndan fletët e votimit në tre grupe:

i) fletëvotimi të parregullta,

ii) fletëvotimi të parregullta të kontestuara,

iii) fletëvotimi të rregullta (të cilat do të vazhdojnë të shqyrtohen nga KQV-ja për të nxjerrë rezultatet e votimit).

b) Në rastet kur kryetari i KQV-së konstaton parregullsinë e një fletevotimi dhe konstatimi i tij pranohet nga të gjithë anëtarët e KQV-së dhe nga të gjithë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, kjo fletëvotimi konsiderohet e parregullt dhe vendoset në tavolinën e punës në grupin “fletëvotimi të parregullta”. Numri i fletëve të votimit të parregullta shënohet në fletoren e procesverbalit të QV-së.

c) Në rastet kur kryetari i KQV-së konstaton parregullsinë e një fletëvotimi dhe konstatimi i tij kundërshtohet nga një anëtar i KQV-së apo një përfaqësues i një subjekti zgjedhor lidhur me parregullsinë e fletës së votimit, çështja hidhet në votim.

d) Në rast se të paktën 5 (pesë) anëtarë të KQV-së votojnë “pro” për parregullsinë e fletës së votimit, atëherë kjo fletëvotimi vendoset në grupin e “fletëve të votimit të parregullta të kontestuara”. Kryetari shënon në anën e pasme të kësaj flete një numër dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shënojë vërejtjet e tij në procesverbal.

e) Në rastet kur më pak se 5 (pesë) anëtarë të KQV-së votojnë “pro” për parregullsinë e fletës së votimit, atëherë kjo fletëvotimi vendoset në grupin e “fletëve të votimit të rregullta”. Kryetari shënon në anën e pasme të kësaj flete një numër dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shënojë vërejtjet e tij në procesverbal.

### Neni 21
### **Vota të vlefshme dhe të pavlefshme për kandidatët për kryetar**

Kryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit vazhdojnë me shqyrtimin e vlefshmërisë apo pavlefshmërisë së votave vetëm për fletët e votimit të rregullta. Fletët e votimit shqyrtohen një nga një, duke filluar me vlerësimin e votave të vlefshme dhe të pavlefshme për kandidatët për kryetar.

a) Kryetari i KQV-së, pasi merr një fletëvotimi, deklaron me zë të lartë se për cilin kandidat është vota e vlefshme, ia tregon atë zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të tjerë të KQV-së dhe nëse konstatimi i tij pranohet nga të gjithë anëtarët e KQV-së dhe nga të gjithë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, fleta e votimit vendoset në grupin e votave të vlefshme për atë kandidat.

b) Në rastet kur një nga anëtarët e KQV-së ose një përfaqësues i një subjekti zgjedhor ka

kundërshtim lidhur me vlefshmërinë e votës së deklaruar nga kryetari për njërin nga kandidatët, çështja hidhet në votim.

c) Nëse të paktën 5 (pesë) anëtarë të KQV-së votojnë "pro" për vlefshmërinë e votës, atëherë kjo fletëvotimi vendoset në grupin e votave të vlefshme për atë kandidat. Kryetari shënon në anën e pasme të pjesës për kandidatët të kësaj fletevotimi një numër (përveç rasteve kur kësaj fletevotimi i është shënuar një numër gjatë shqyrtimit të mëparshëm) dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shënojë vërejtjet e tij në procesverbal.

d) Nëse më pak se 5 (pesë) anëtarë të KQV-së votojnë "pro" për vlefshmërinë e votës, atëherë kjo fletëvotimi vendoset në grupin e votave të pavlefshme për kandidatët. Kryetari shënon në anën e pasme të pjesës për kandidatët të kësaj fletevotimi një numër (përveç rasteve kur kësaj flete votimi i është shënuar një numër gjatë shqyrtimit të mëparshëm) dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shënojë vërejtjet e tij në procesverbal.

e) Në rastet kur kryetari i KQV-së konstaton pavlefshmërinë e një vote dhe konstatimi i tij pranohet nga të gjithë anëtarët e KQV-së dhe nga të gjithë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, fleta e votimit vendoset në grupin e votave të pavlefshme për kandidatët.

f) Në rastet kur kryetari i KQV-së konstaton pavlefshmërinë e një vote dhe konstatimi i tij kundërshtohet nga një anëtar i KQV-së apo një përfaqësues i një subjekti zgjedhor çështja hidhet në votim.

g) Në rast se të paktën 5 (pesë) anëtarë të KQV-së votojnë "pro" për pavlefshmërinë e votës, atëherë kjo fletëvotimi vendoset në grupin e "votave të pavlefshme". Kryetari shënon në anën e pasme të pjesës për kandidatët të kësaj fletevotimi një numër (përveç rasteve kur kësaj fletevotimi i është shënuar një numër gjatë shqyrtimit të mëparshëm) dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shënojë vërejtjet e tij në procesverbal.

h) Në rast se më pak se 5 (pesë) anëtarë të KQV-së votojnë "pro" për pavlefshmërinë e votës atëherë kjo fletëvotimi vendoset në grupin e votave të vlefshme për kandidatin për të cilin vlerësohet kjo votë. Kryetari shënon në anën e pasme të pjesës për kandidatët të kësaj fletevotimi një numër (përveç rasteve kur kësaj fletevotimi i është shënuar një numër gjatë shqyrtimit të mëparshëm) dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shënojë vërejtjet e tij në procesverbal.

i) Kryetari dhe anëtarët e tjerë të KQV-së numërojnë votat e vlefshme që ka marrë çdo kandidat për kryetar dhe i shënojnë ato në procesverbal. Numri i votave të vlefshme për kandidatët për kryetar duhet të jetë i njëjtë me shumën e votave të vlefshme që ka marrë secili nga kandidatët për kryetar.

Neni 22

**Vota të vlefshme dhe të pavlefshme për listat shumemërore**

Fletët e votimit grumbullohen sërish dhe shqyrtohen një nga një, duke vlerësuar këtë radhë votat e vlefshme dhe të pavlefshme për listat shumemërore.

a) Kryetari i KQV-së, pasi merr një fletëvotimi, deklaron me zë të lartë se për cilën listë shumemërore është vota e vlefshme, ia tregon atë zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të tjerë të KQV-së dhe nëse konstatimi i tij pranohet nga të gjithë anëtarët e KQV-së dhe nga të gjithë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, fleta e votimit vendoset në grupin e votave të vlefshme për atë listë shumemërore.

b) Në rastet kur një nga anëtarët e KQV-së ose një përfaqësues i një subjekti zgjedhor ka kundërshtim, lidhur me vlefshmërinë e votës së deklaruar nga kryetari për njërën nga listat shumemërore, çështja hidhet në votim.

c) Nëse të paktën 5 (pesë) anëtarë të KQV-së votojnë "pro" për vlefshmërinë e votës, atëherë kjo fletëvotimi vendoset në grupin e votave të vlefshme për atë listë shumemërore. Kryetari shënon në anën e pasme të pjesës për listat shumemërore të kësaj fletevotimi një numër (përveç rasteve kur kësaj

fletevotimi i është shënuar një numër gjatë shqyrtimit të mëparshëm) dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shënojë vërejtjet e tij në procesverbal.

d) Nëse më pak se 5 (pesë) anëtarë të KQV-së votojnë “pro” për vlefshmërinë e votës, atëherë kjo fletëvotimi vendoset në grupin e votave të pavlefshme për listat shumemërore. Kryetari shënon në anën e pasme të pjesës për listat shumemërore të kësaj fletevotimi një numër (përveç rasteve kur kësaj fletevotimi i është shënuar një numër gjatë shqyrtimit të mëparshëm) dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shënojë vërejtjet e tij në procesverbal.

e) Në rastet kur kryetari i KQV-së konstaton pavlefshmërinë e një vote dhe konstatimi i tij pranohet nga të gjithë anëtarët e KQV-së dhe nga të gjithë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, fleta e votimit vendoset në grupin e votave të pavlefshme për listat shumemërore.

f) Në rastet kur kryetari i KQV-së konstaton pavlefshmërinë e një vote dhe konstatimi i tij kundërshtohet nga një anëtar i KQV-së apo një përfaqësues i një subjekti zgjedhor, çështja hidhet në votim.

g) Në rast se të paktën 5 (pesë) anëtarë të KQV-së votojnë “pro” për pavlefshmërinë e votës atëherë kjo fletëvotimi vendoset në grupin e votave të pavlefshme. Kryetari shënon në anën e pasme të pjesës për listat shumemërore të kësaj flete votimi një numër (përveç rasteve kur kësaj fletevotimi i është shënuar një numër gjatë shqyrtimit të mëparshëm) dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shënojë vërejtjet e tij në procesverbal.

h) Në rast se më pak se 5 (pesë) anëtarë të KQV-së votojnë “pro” për pavlefshmërinë e votës atëherë kjo fletëvotimi vendoset në grupin e votave të vlefshme për listën shumemërore për të cilën vlerësohet kjo votë. Kryetari shënon në anën e pasme të pjesës për listat shumemërore të kësaj fletevotimi një numër (përveç rasteve kur kësaj fletevotimi i është shënuar një numër gjatë shqyrtimit të mëparshëm) dhe e regjistron atë në procesverbal së bashku me natyrën e problemit dhe arsyetimin e vendimit. Çdo anëtar ose përfaqësues tjetër mund të shënojë vërejtjet e tij në procesverbal.

i) Kryetari dhe anëtarët e tjerë të KQV-së numërojnë votat e vlefshme që ka marrë çdo listë shumemërore dhe i shënojnë ato në procesverbal. Numri i votave të vlefshme për listën shumemërore duhet të jetë i njëjtë me shumën e votave të vlefshme që ka marrë secila nga lista shumemërore.

## PJESA IV
## ADMINISTRIMI I FLETËVE TË VOTIMIT DHE VEPRIMET PËRMBYLLËSE

### Neni 23
### **Administrimi i fletëve të votimit dhe zarfet e posaçme**

Pas numërimit dhe regjistrimit të votave, fletët e votimit të gjetura në kutinë e votimit vendosen në zarfet përkatëse, si më poshtë:

a) në zarfin me mbishkrimin “ZARFI I FLETËVE TË VOTIMIT TË PARREGULLTA” vendosen fletët e votimit të konsideruara të parregullta nga të gjithë anëtarët e KQV-së dhe nga të gjithë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore;

b) në zarfin me mbishkrimin “ZARFI I VOTAVE TË VLEFSHME” vendosen ato fletëvotimi në të cilat si vota për kandidatët, ashtu edhe vota për partitë a koalicionet është konsideruar e vlefshme nga të gjithë anëtarët e KQV-së dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore;

c) në zarfin me mbishkrimin “ZARFI I VOTAVE TË PAVLEFSHME” vendosen ato fletë votimi në të cilat ose vota për kandidatët, ose vota për partitë a koalicionet është konsideruar e pavlefshme nga të gjithë anëtarët e KQV-së dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore;

d) në zarfin me mbishkrimin “ZARFI I FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA” vendosen ato fletëvotimi të cilat janë konsideruar të parregullta, të vlefshme ose të pavlefshme me votim të KQV-së, por që janë kundërshtuar nga të paktën një anëtar i KQV-së ose një përfaqësues i një subjekti zgjedhor.

Neni 24
**Administrimi i zarfeve të fletëve të votimit**

Kryetari i KQV-së mbyll secilin nga zarfet ku janë futur fletët e votimit dhe së bashku me zëvendëskryetarin bëjnë plotësimet përkatëse mbi zarfet. Kryetari dhe zëvendëskryetari firmosin në vendet përkatëse mbi zarf, ndërsa sekretari vendos vulën e KQV-së në vendin ku mbyllet zarfi.

Neni 25

Zarfet futen në kutinë e votimit së bashku me:
a) kopjet origjinale të tabelave,
b) procesverbalet dhe vulën e KQV-së,
c) vendimet e KQV-së së bashku me mendimet e pakicës, në lidhje me tabelën e rezultateve të qendrës së votimit, si dhe vlefshmërinë e fletëve të votimit.

Materialet zgjedhore dorëzohen në KZQV-në përkatëse nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari, brenda 24 orëve nga mbyllja e votimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**UDHËZIM**
**Nr.10, datë 27. 9. 2003**

**PËR RREGULLAT QË DUHEN RESPEKTUAR PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2003, me pjesëmarrjen e:

| | |
|---|---|
| Ilirjan Celibashi | Kryetar |
| Dodë Prenga | Anëtar |
| Tomor Malaj | Anëtar |
| Klement Zguri | Anëtar |
| Dëshira Subashi | Anëtar |
| Pandeli Varfi | Anëtar |

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe nenit 135 të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1
**Parim i përgjithshëm**

Organet e qeverisjes vendore caktojnë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore.

Neni 2
**Caktimi i vendeve të afishimit**

1. Caktimi i këtyre vendeve duhet të realizohet duke përcaktuar sipërfaqe dhe kohë afishimi të barabarta ndërmjet partive të pozitës dhe opozitës pjesëmarrëse në zgjedhje.

2. Për partitë parlamentare që në zgjedhjet e fundit kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në parlament, bashkia/ komuna, caktojnë dyfishin e sipërfaqes së afishimit të partive nën 20%.

3. Në caktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propogandistike, organet e qeverisjes vendore duhet të kenë parasysh:

- sheshet publike dhe afërsinë e tyre me qendrën e qytetit;
- rrugët kryesore;
- vendet e veçanta;
- mundësinë e ndriçimit;
- kohën e barabartë në dispozicion.

Neni 3
**Personat juridikë dhe fizikë**

Për aq sa është e mundur, bashkitë/ komunat, kërkojnë zbatimin e rregullave të përcaktuara në nenin 1 dhe 2 të këtij udhëzimi edhe nga personat juridikë dhe fizikë, që ushtrojnë aktivitet në fushën e reklamave në njësinë administrative përkatëse.

Neni 4
**Respektimi i barazisë**

1. Rritja e hapësirave për afishimin e materialeve propagandistike, për njërin nga subjektet zgjedhore, rrit proporcionalisht hapësirën për subjektet e tjera.

2. Vënia në dispozicion e sipërfaqeve për afishimin e materialeve propagandistike bëhet me të njëjtin çmim për sipërfaqe dhe kohë afishimi të barabartë.

Neni 5
**Kompensimi**

Në rastet kur KZQV-ja konstaton një ndarje të pabarabartë në kohë ose hapësirë midis subjekteve zgjedhorë të forcave ose blloqeve politikë të ndryshme, vendos kompensimin me sipërfaqe dhe kohë të afishimit në favor të subjekteve të dëmtuara, kompensim i cili duhet të realizohet brenda 24 orëve nga marrja e vendimit. Bashkia/komuna përkatëse detyrohet për zbatimin e vendimit të KZQV-së.

Neni 6
**Sanksionet**

Në rastet kur KQZ-ja konstaton kundërvajtje administrative, si dhe pasi ka marrë mendimin e KZQV-së përkatëse, vendos sanksione në përputhje me ligjin nr. 9087, datë 19. 06. 2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 7

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

## UDHËZIM
## Nr.11, datë 29.9.2003

### PËR MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË LISTËS SË ZGJEDHËSVE QË PËRDOR KQV DITËN E VOTIMIT PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE 2003

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe 6 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

UDHËZON:

1. Pas evidentimit të numrit të zgjedhësve që kanë votuar, sipas nënshkrimeve në listën e zgjedhësve, kjo listë futet në zarf, zarfi nënshkruhet nga kryetari e zëvendëskryetari i KQV-së dhe vuloset nga kryetari i saj.

2. Në fund të procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultateve në QV, zarfi ku është vendosur lista e zgjedhësve futet në kutinë e votimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë

## UDHËZIM
## Nr.12, datë 30.9.2003

### MBI MENYRËN E ADMINISTRIMIT TË TABELAVE TË REZULTATEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT NGA KOMISIONI ZGJEDHOR I QEVERISJES VENDORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 29 pika 1 dhe 109 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

UDHËZON:

1. Komisioni Zgjedhor i Qeverisjes Vendore administron tabelat e rezultateve të qendrave të votimit dhe nxjerr në bazë të tyre rezultatin e zgjedhjeve për njësinë zgjedhore.

2. KZQV administron tabelat e rezultateve të qendrave të votimit sipas kësaj procedure:

a) Pasi verifikon kodet e vulave të kutisë së votimit dhe i shënon ato në procesverbal, hap kutinë e qendrës së votimit.

b) Verifikon nëse kutia përmban kopjen origjinale të tabelës së rezultateve të qendrës së votimit.

c) Nxjerr kopjen origjinale të tabelës, lexon përmbajtjen e tabelës dhe shënon rezultatet në procesverbalin e KZQV-së.

d) Përpara se KQV të vendosë tabelën e rezultateve të qendrës së votimit sërish në kutinë e votimit, kryetari i KZQV-së lexon edhe njëherë me zë të lartë të dhënat e tabelës. Çdo anëtar i KZQV-së mund të verifikojë tabelën e rezultateve. Miratimi i të dhënave nga anëtarët e KZQV-së shënohet në procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KZQV-së.

e) Fut përsëri tabelën e rezultateve në kutinë e votimit dhe e mbyll kutinë e votimit me vula me kod.

3. Procedura e përcaktuar në nenin 2 të këtij udhëzimi përsëritet nga KZQV-ja për çdo kuti votimi.

4. Tabela e rezultateve e ardhur dorazi në KZQV nga çdo KQV, në zarf të posaçëm dërgohet në KQZ, së bashku me materialet e tjera zgjedhore.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

## UDHËZIM
## Nr. 13 datë 3.10.2003

## PËR SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E FLETËVE TË VOTIMIT NGA KQV

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe pika 3, si dhe nenit 93 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

1. Shpërndarja e fletëve të votimit për çdo KZQV do të bëhet jo me vonë se tri ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Shpërndarja e fletëve të votimit nga KZQV-ja në çdo KQV të bëhet jo me vonë se 12 orë para hapjes së votimit, sipas formulës që vijon:

a) Pjesëtohet numri i fletëve të votimit që i janë dhënë KZQV-së nga KQZ-ja, me numrin e votuesve në listën përfundimtare të zgjedhësve për të njëjtën KZQV.

b) Rezultati i pjesëtimit shumëzohet me numrin e votuesve të listës përfundimtare të qendrës së votimit dhe shifra që rezulton nga shumëzimi është numri i fletëve të votimit që KZQV-ja duhet t'i japë KQV-së përkatëse.

3. Kjo procedurë kryhet për çdo qendër votimi të KZQV-së.

4. KZQV-ja nuk mban asnjë fletëvotimi gjendje (rezervë).

5. Për përdorimin e fletëve të votimit, komisionet e qendrave të votimit veprojnë si vijon:

a) Në fillim të çeljes së votimeve kryetari dhe zëvendëskryetari rendisin blloqet e fletëve të votimit, në mënyrë që blloku që ka numrin më të vogël të serisë të jetë në krye, e mandej të vazhdojë rritja numerike progresive deri tek numri më i madh. Pas kryerjes së këtij veprimi, kryetari dhe zëvendëskryetari firmosin deri 50 copë fletëvotimi, të cilat vulosen nga sekretari i KQV-së një nga një në momentin që i jepen votuesit. Më tej firmosja e fletëve të votimit do të shkojë paralel me intensitetin e paraqitjes së votuesve dhe në total, në fund të procesit të votimit duhet të jenë firmosur, vulosur dhe përdorur aq fletëvotimi sa votues kanë marrë pjesë në votim.

b) Fletët e votimit të papërdorura nuk duhet të kenë firma e vula.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

## UDHËZIM
## Nr.14, datë 5.10.2003

## PËR MIRATIMIN E DETYRAVE TE POLICISË SË SHTETIT DHE FORCAVE TË USHTRISË PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE 2003

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe nenit 104, 105, pika 4 dhe nenit 116 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të neneve 60/a deri 60/ç të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit, me qëllim garantimin e ecurisë normale të procesit zgjedhor", si dhe të aktit normativ nr.3, datë 19.9.2003 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", ndryshuar me ligjet nr.8933, datë 25.7.2002 dhe nr.8098 datë 26.5.2003"

UDHËZON:

PJESA I

Neni 1
**Parime të përgjithshme**

a) Në të gjitha llojet e zgjedhjeve që zhvillohen në Shqipëri, rendi dhe siguria gjatë periudhës zgjedhore ruhet nga forcat e Policisë së Shtetit.

b) Përdorimi i forcave speciale të policisë dhe forcave të ndërhyrjes së shpejtë, lidhur me ngjarje që kanë të bëjnë me zgjedhjet, në veprime që mund të ndikojnë në intimidimin e zgjedhësve ose që në çfarëdolloj forme mund të kushtëzojnë vullnetin e zgjedhësve, është i ndaluar.

c) Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe i forcave të tjera të ushtrisë për ruajtjen e objekteve që kanë lidhje me zgjedhjet.

d) Forcat e ushtrisë ndalohen të kryejnë ushtrime apo manovra ushtarake jashtë reparteve ose vendeve të dislokimit të tyre, gjatë gjithë periudhës zgjedhore.

e) Përdorimi ose pjesëmarrja e punonjësve a strukturave të SHISH-it, lidhur me ngjarje që kanë të bëjnë me zgjedhjet, në veprime që mund të ndikojnë në intimidimin e zgjedhësve ose që në çfarëdolloj forme mund të kushtëzojnë vullnetin e zgjedhësve, është i ndaluar.

Neni 2

**Komunikimi ndërmjet forcave të policisë dhe ushtrisë dhe KQZ-së**

a) Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është i detyruar që për të gjithë kohëzgjatjen e periudhës zgjedhore të dorëzojë menjëherë në KQZ kopje të çdo urdhri për angazhimin e forcave të Policisë së Shtetit në zbatim të detyrave të tyre ligjore.

b) Kur forcat komando dhe forcat e tjera të ushtrisë nevojiten gjatë periudhës zgjedhore për ruajtjen e objekteve të rëndësisë të veçantë ose në zëvendësim të punonjësve të policisë së objekteve, ato përdoren vetëm me urdhër me shkrim të Ministrit të Rendit Publik dhe Ministrit të Mbrojtjes. Kopje e urdhrit me shkrim i dërgohet menjëherë KQZ-së.

c) Në rast se KQZ-ja vlerëson se veprimtaria e institucionit mund të dëmtojë ose ta pengojë administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente, KQZ-ja informon menjëherë me shkrim institucionin përkatës.

d) KQZ-ja i dërgon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit listën e plotë të objekteve zgjedhore dhe adresat e sakta të vendndodhjes së tyre.

e) Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është i detyruar t'i paraqesë KQZ-së listën e plotë të punonjësve të ngarkuar me detyra gjatë zgjedhjeve.

f) Për secilin nga punonjësit e përfshirë në listë, duhet të përcaktohen me shkrim të dhënat personale (emri dhe mbiemri), grada që mban, vendvendosja e punonjësit gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe në ditën e votimit, emri i eprorit të drejtpërdrejtë të tij, lloji i shërbimit të policisë ku bën pjesë, si dhe në mënyrë të detajuar rrethi i detyrave të ngarkuara.

g) KZQV-të, për problemet që mund të lindin gjatë periudhës zgjedhore dhe që kanë të bëjnë me sjelljen dhe qëndrimin e punonjësve të veçantë të policisë, i drejtohen Drejtorit të Policisë së Qarkut ku ndodhet KZQV-ja dhe njëkohësisht lajmërojnë KQZ-në. KQZ, nga ana e saj, komunikon me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

h) Drejtori i Përgjithshëm i Policisë është i detyruar të informojë menjëherë KQZ-në, për të gjitha ndryshimet që i shkaktohen listës ose të dhënave të përfshira në të.

Neni 3

**Veshja dhe armatimi i policisë**

a) Të gjithë punonjësit e forcave të policisë të përfshirë me detyra gjatë zgjedhjeve janë të detyruar të mbajnë në publik gjatë gjithë periudhës së zgjedhjeve dokumentin e identifikimit, të miratuar me vendimin e KQZ-së nr.1915, datë 29.9.2003 "Për miratimin e dokumenteve të identifikimit që do të mbajnë punonjësit e policisë të ngarkuar me detyra gjatë zgjedhjeve vendore 2003".

b) Punonjësit e forcave të policisë që ngarkohen me detyra gjatë zgjedhjeve pajisen vetëm me armatim personal brezi (pistoletë). Punonjësit e shërbimit lejohen që, përveç armatimit personal të brezit, të mbajnë dhe automatik në rastet kur:

I) ngarkohen me ruajtjen e qendrës së votimit gjatë natës përpara ditës së votimit deri në momentin e hapjes së qendrës së votimit;

II) ngarkohen me shoqërimin e kutive dhe materialeve të votimit nga qendra e votimit në KZQV, vetëm për momentin e shoqërimit.

Neni 4
**Lëvizjet e policisë**

Qarkullimi i forcave të policisë të ngarkuara me detyra zgjedhore brenda territorit elektoral bëhet vetëm me mjete policie dhe vetëm në rast se kërkohet ndërhyrja e tyre nga KQZ-ja, KZQV-ja ose nga KQV-ja, në zbatim të neneve 104 ose 105 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Mjetet e përdorura nga policia në këtë rast do të kenë shenja dalluese që tregojnë se këto forca janë ngarkuar me detyra në funksion të zgjedhjeve.

Neni 5
**Vendqëndrimi i policisë**

a) Asnjë person i armatosur, duke përfshirë edhe forcat e policisë dhe ushtarakët, nuk lejohet të hyjë dhe qëndrojë në mjediset e qendrës së votimit, me përjashtim të rastit kur kërkohet përkatësisht nga KQZ-ja, KZQV-ja ose nga KQV-ja.

b) Punonjësit e forcave të policisë, që ngarkohen me detyra gjatë zgjedhjeve (në çdo rast me forca policie të ngarkuara me detyra gjatë zgjedhjeve, do të kuptohen vetëm punonjësit e forcave të policisë të cilët do të kenë detyrë garantimin e qetësisë dhe kushteve normale gjatë periudhës së zgjedhjeve) në 24 orët para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve qëndrojnë brenda komisariateve ose në vende dislokimi larg qendrave të banuara. Bëjnë përjashtim punonjësit e ngarkuar me detyra sipas nenit 3 paragrafi b (I, II)

Neni 6
**Kërkesa për t'u futur në ambientet e QV-së**

a) Kur në qendrën e votimit rrezikohet rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit, KQV-ja vendos pezullimin e votimit dhe kërkon ndihmën e policisë.

b) Kërkesa paraqitet me shkrim dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe rrethanave. Kërkesa nënshkruhet nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KQV-së dhe i njoftohet menjëherë komisariatit ose vendqëndrimit më të afërt të policisë.

c) Sapo forcat e policisë paraqiten në qendrën e votimit, kërkesa për të ndërhyrë i dorëzohet menjëherë punonjësit të policisë me gradë më të lartë.

d) Kryetari ose zëvendëskryetari i KQV-së njofton menjëherë KZQV-në për incidentin e ndodhur.

e) Me rivendosjen e rendit në qendrën e votimit, KQV-ja (kryetari dhe zëvendëskryetari) u kërkon forcave të policisë të largohen nga qendra e votimit dhe merr masa për rifillimin e menjëhershëm të votimit.

Neni 7
**Paraqitja e kërkesës për të garantuar transportimin e kutive të votimit dhe procesverbalet**

a) Me përfundimin e procesit të nxjerrjes së rezultatit, KQV-ja lajmëron policinë për t'i garantuar sigurinë e transportimit të kutisë së votimit dhe zarfit me procesverbalet e votimit deri në KZQV.

b) Komisariati i policisë siguron menjëherë forcat dhe mjetin e nevojshëm të policisë për të garantuar sigurinë e transportimit.

Neni 8
**Mënyra e shoqërimit të kutive të votimit dhe procesverbaleve**

a) Gjatë shoqërimit kutia dhe materialet e tjera zgjedhore administrohen vetëm prej kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KQV-së. Punonjësi i forcave të policisë nuk ka të drejtë në asnjë

rast që të posedojë ose të ketë kontakt me materialet e mësipërme.

b) Pasi kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KQV-së futen në KZQV, forcat e policisë largohen menjëherë.

Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**UDHËZIM**
**Nr.15, datë 9.10.2003**

## MBI PROCEDURËN E RINUMËRIMIT TË VOTAVE

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 nenit 111 deri 115 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e kritereve dhe procedurave që do të ndiqen për rinumërimin e fletëve të votimit.

Neni 2
**Parime të përgjithshme**

Rinumërimi i fletëve të votimit kryhet në një sallë publike.

Neni 3

Para fillimit të procedurës së votimit kutitë e votimit të të gjitha qendrave të votimit të njësisë zgjedhore duhet të jenë në sallë.

PJESA I
KRITERET E RINUMËRIMIT TË FLETËVE TË VOTIMIT

Neni 4
**Rastet e rinumërimit**

Rinumërimi i votave për kandidatët për kryetar bashkie/komune mund të kërkohet vetëm në një nga rastet e mëposhtme:

a) kur diferenca midis votave të kandidatit që ka dalë i pari dhe kandidatit që ka dalë i dyti është më e vogël se numri i votave të pavlefshme gjatë numërimit;

b) kur diferenca midis votave të kandidatit që ka dalë i pari dhe kandidatit që ka dalë i dyti është jo më shumë se 150 vota.

Neni 5
**Kërkesa për rinumërimin e fletëve të votimit**

Kërkesa për rinumërimin e fletëve të votimit i dorëzohet kryetarit, zëvendëskryetarit ose sekretarit të KZQV-së përkatëse dhe duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e subjektit të interesuar;

b) objektin e kërkesës;

c) bazën ligjore të saj;

d) nënshkrimin e subjektit të interesuar.

Me subjekt të interesuar, sipas këtij neni, do të kuptohen kandidati, përfaqësuesi i kandidatit ose i partisë/koalicionit që mbështet kandidatin.

Neni 6
**Afati i kërkesës për rinumërim**

Subjektet e interesuara kanë të drejtë të kërkojnë rinumërimin e votave brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve në njësinë zgjedhore përkatëse.

Neni 7
**Vendimi i KZQV-së**

Nëse kërkesa plotëson të gjitha kushtet e parashikuara në nenet 4, 5 dhe 6 të këtij udhëzimi, KZQV-ja merr menjëherë vendim për pranimin ose jo të kërkesës për rinumërimin e fletëve të votimit dhe njofton menjëherë KQZ-në.

Ky vendim shpallet në një vend publik në hyrje të ndërtesës së KZQV-së.

PJESA II

Neni 8
**Veprimet përgatitore të KZQV-së**

Menjëherë pas marrjes së vendimit për rinumërimin e fletëve të votimit dhe shpalljes së tij KZQV-ja kryen detyrat e mëposhtme:

a) njofton subjektet e interesuara;

b) njofton përfaqësuesit e akredituar të kandidatëve ose partive politike;

c) siguron një sallë publike me sipërfaqe të mjaftueshme për të mbajtur kutitë e votimit të të gjitha qendrave të votimit të njësisë zgjedhore, anëtarët e KZQV-së, si dhe për përfaqësuesit e akredituar të kandidatëve ose partive që dëshirojnë të jenë të pranishëm.

Neni 9
**Kohëzgjatja e procesit të rinumërimit të fletëve të votimit**

KZQV-ja organizon dhe fillon rinumërimin e fletëve të votimit brenda 24 orëve nga marrja e vendimit për rinumërim.

Rinumërimi i fletëve të votimit fillon në orën $8^{00}$ dhe vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në përfundimin e tij.

Në asnjë rast nuk lejohet ndërprerja e rinumërimit të fletëve të votimit.

Neni 10
**Personat e pranishëm gjatë rinumërimit**

1. Gjatë rinumërimit të fletëve të votimit duhet të jenë të pranishëm një përfaqësues i caktuar nga KQZ-ja dhe anëtarët e KZQV-së.

2. Në procesin e rinumërimit mund të marrë pjesë vetëm një përfaqësues për çdo subjekt

zgjedhor.

Neni 11
**Personat që kryejnë rinumërimin**

Rinumërimi i fletëve të votimit kryhet nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZQV-së të ndihmuar dhe nga sekretari i KZQV-së.

Në të gjitha rastet, kur mungon një nga personat e sipërpërmendur, njoftohet menjëherë KQZ-ja.

Neni 12
**Kutitë e votimit**

Sekretari i KZQV-së ose në mungesë të tij, një anëtar i autorizuar nga kryetari i KZQV-së përkatëse, sjell të gjitha kutitë e votimit dhe procesverbalet e votimit në vendin ku bëhet rinumërimi.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i KZQV-së verifikojnë nëse kutitë e votimit dhe procesverbalet janë vendosur në një vend të dukshëm.

Neni 13
**Vulat e kutive të votimit**

Para hapjes së kutisë së votimit, kryetari dhe zëvendëskryetari i KZQV-së verifikojnë nëse të gjitha vulat e kutisë së votimit janë të njëjta me vulat e shënuara në procesverbalet e KZQV-së. Nëse vulat nuk janë të njëjta, kutia nuk duhet të hapet.

PJESA III
PROCEDURA PAS HAPJES SË KUTIVE TË VOTIMIT

Neni 14
**Radha e rinumërimit**

Rinumërimi i fletëve të votimit fillon nga kutia e qendrës së votimit me numrin SUN më të vogël dhe vazhdon me radhë me kutitë e qendrave të tjera të votimit, sipas numrit rendor të tyre.

Neni 15
**Procedura e rinumërimit të fletëve të votimit**

Pasi verifikohet se vulat e kutisë së votimit janë të njëjta me vulat e shënuara në procesverbalet e KZQV-së, kryetari dhe zëvendëskryetari, të ndihmuar nga sekretari, procedojnë në mënyrë plotësisht të dukshme për të pranishmit dhe sipas radhës së mëposhtme:

a) Sekretari hap kutinë dhe nxjerr procesverbalet, tabelat dhe vulën e KQV-së dhe verifikon nëse ato janë materialet e rregullta të asaj qendre votimi.

b) Sekretari nxjerr zarfet me fletët e votimit të numëruara në qendrën e votimit, zarfet me fletët e votimit të pavlefshme dhe zarfet me fletët e votimit të dëmtuara gjatë votimit, si dhe fletët e votimit të papërdorura dhe kundërfletët.

c) Kryetari dhe zëvendëskryetari verifikojnë të dhënat e tabelave në lidhje me numrin e fletëve të votimit të papërdorura, numrin e kundërfletës së fundit, numrin e fletëve të votimit të dëmtuara dhe numrin e fletëve të votimit të kontestuara. Kryetari dhe zëvendëskryetari i vendosin këto materiale në zarfin e caktuar për këtë qëllim dhe i shënojnë të dhënat në procesverbalin e rinumërimit.

ç) Kryetari dhe zëvendëskryetari hapin zarfet me fletët e votimit, pa i kontrolluar ato dhe i grupojnë sipas zarfit nga i cili nxirren. Fletët e votimit të gjetura në zarfe numërohen dhe rezultati krahasohet me numrin e shënuar në tabelën e qendrës së votimit. Në rast mospërputhjeje, konsiderohet i saktë numri i fletëve të votimit të gjetura në zarf gjatë rinumërimit.

d) Pasi verifikojnë numrin e votave, sipas tabelës së qendrës së votimit kryetari dhe zëvendëskryetari vazhdojnë me shqyrtimin e të gjitha fletëve të votimit, duke kontrolluar nëse fleta e

votimit është vulosur dhe nënshkruar sipas nenit 91 të këtij Kodi dhe deklarojnë se për kë është votuar. Gjatë rinumërimit kryetari dhe zëvendëskryetari ushtrojnë kompetencat e KQV-së dhe mund të ndryshojnë vendimin e KQV-së të shënuar në procesverbal.

dh) Gjatë shqyrtimit të një fletevotimi që është kundërshtuar nga një ose më shumë anëtarë ose përfaqësues të KQV-së ose që është shpallur e pavlefshme nga KQV-ja gjatë numërimit, kryetari dhe zëvendëskryetari shqyrtojnë të gjitha kundërshtimet dhe vërejtjet që gjenden në procesverbalin e votimit në lidhje me atë fletëvotimi. Pasi marrin vendim në lidhje me atë fletëvotimi, kryetari dhe zëvendëskryetari sqarojnë arsyet përkatëse, të cilat mbahen shënim në procesverbalin e rinumërimit.

e) Pas shqyrtimit të të gjitha fletëve të votimit të gjendura në kutitë e votimit, kryetari dhe zëvendëskryetari kryejnë detyrat e mëposhtme:

- Shpallin rezultatet e qendrës së votimit dhe hartojnë procesverbalin e rinumërimit të votave për qendrën e votimit.
- E nënshkruajnë atë së bashku me sekretarin.
- Rivendosin të gjitha materialet në kutinë e votimit.
- Lejojnë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, kandidatët dhe anëtarët e komisionit të zgjedhjeve të shqyrtojnë procesverbalet e votimit dhe të mbajnë shënime.
- Vulosin kutinë e votimit dhe fillojnë të njëjtën procedurë për qendrën tjetër të votimit.

Neni 16

**Marrja e vendimeve**

1. Vendimet para dhe gjatë procedurës së rinumërimit të fletëve të votimit merren nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZQV-së përkatëse.
2. Në të gjitha rastet, kur nuk është e mundur marrja e një vendimi prej kryetarit dhe zëvendëskryetarit, vendimi merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZQV-së, duke përfshirë edhe kryetarin dhe zëvendëskryetarin.
3. Vendimet e marra gjatë rinumërimit të fletëve të votimit janë të formës së prerë, ndërsa rezultatet janë të ankimueshme.

Neni 17

**Listat shumemërore**

Fletët e votimit për listat shumemërore nuk rinumërohen.

PJESA IV

PROCEDURA PAS KRYERJES SË RINUMËRIMIT

Neni 18

**Tabelat e rinumërimit**

Në fund të rinumërimit, kryetari dhe zëvendëskryetari plotësojnë tabelën e rinumërimit të fletëve të votimit të njësisë zgjedhore, bashkisë/komunës në formën e caktuar nga KQZ-ja dhe u lëshon nga një kopje anëtarëve të KZQV-së përkatëse, përfaqësuesit të KQZ-së dhe çdo kandidati ose përfaqësuesi të pranishëm.

Neni 19

**Shpallja e rezultatit**

Pasi plotëson tabelën e rinumërimit, KZQV-ja shpall menjëherë rezultatin e zgjedhjeve në njësinë zgjedhore.

Neni 20

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

# UDHËZIM
# Nr.16, datë 10.10.2003

## MBI PROCEDURËN E VOTIMIT TË ZGJEDHËSVE TË VEÇANTË

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 61 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

UDHËZON:

Neni 1
**Qëllimi i këtij udhëzimi**

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e kritereve dhe procedurave të votimit të zgjedhësve të veçantë, anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit, që janë të regjistruar në një qendër votimi të ndryshme nga ajo ku kanë vendbanimin ose vendqëndrimin brenda njësisë zgjedhore përkatëse.

Neni 2
**Procedura e votimit**

Të gjithë zgjedhësit që janë caktuar si anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit, në qendra votimi të ndryshme prej atyre ku ata kanë vendbanimin ose vendqëndrimin brenda njësisë zgjedhore përkatëse, evidentohen dhe regjistrohen prej KZQV-ve respektive në një listë të posaçme.

Kjo listë përmban të dhënat personale të secilit prej tyre, numrin e qendrës së votimit ku zgjedhësi i veçantë është regjistruar, si dhe atë ku ai është caktuar si anëtar i komisionit të qendrës së votimit.

Bazuar në këtë listë, KZQV-ja merr vendim për lejimin e zgjedhësit të veçantë për të votuar në qendrën e votimit ku ai është anëtar i KQV-së, dhe për të mos e lejuar atë të votojë në qendrën e votimit ku ai ndodhet i regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Një kopje e vendimit i dërgohet KQV-së ku zgjedhësi është anëtar dhe një kopje tjetër KQV-së ku zgjedhësi është regjistruar në listën e zgjedhësve.

Neni 3

Anëtarët e KQV-së do të votojnë në fund të votimit, kur të mos ketë më zgjedhës që presin të votojnë.

Neni 4

Modeli i vendimit të KQZ-së që lejon zgjedhësin e veçantë për të votuar në qendrën e votimit ku ai është anëtar i KQV-së, miratohet me vendim të KQZ-së.

Neni 5

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**UDHËZIM**
**Nr.17, datë 10.10.2003**

## PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE QË VOTOJNË ME VENDIM GJYKATE

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 100 pika 6 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e procedurës së votimit të zgjedhësve që nuk janë regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve dhe paraqiten në qendrën e votimit me një vendim gjykate që i jep të drejtën për të votuar.

Neni 2

Zgjedhësit që nuk janë regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve lejohen të votojnë kur paraqesin një vendim gjykate që u jep të drejtën të votojnë në atë qendër votimi.

Neni 3

a) Pas hyrjes në qendrën e votimit, zgjedhësi thotë emrin dhe paraqet para KQV-së një prej dokumeteve të mëposhtme:
1. certifikatë me fotografi,
2. letërnjoftim,
3. pasaportë.
b) Zgjedhësi paraqet para komisionit të qendrës së votimit vendimin e gjykatës që i jep të drejtën për të votuar në QV.
c) Komisioni i QV-së verifikon paraprakisht, nëse emri i zgjedhësit figuron në listën përfundimtare të zgjedhësve të QV-së.
d) Në rast se nga verifikimi rezulton se emri i zgjedhësit nuk figuron në listën e zgjedhësve, ai e regjistron atë në një regjistër të veçantë.
e) Zgjedhësi nënshkruan në regjistrin e veçantë përkrah emrit të tij.
ë) Vendimi i gjykatës ruhet prej KQV-së.

Neni 4

Pas mbarimit të procedurës së mësipërme, zgjedhësit i jepet fleta e votimit dhe lejohet të votojë.

Neni 5

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**UDHËZIM**
**Nr.18, datë 11.10.2003**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E KQZ-SË NR.9, DATË 20.9.2003 “MBI PROCEDURAT E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE ADMINISTRIMIN E FLETËVE TË VOTIMIT NGA KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’’,

UDHËZON:

Në udhëzimin e KQZ-së nr.9, datë 20.9.2003 “Mbi procedurat e numërimit të votave dhe administrimin e fletëve të votimit nga komisioni i qendrës së votimit” të bëhen këto shtesa:

1. Në nenin 21 “vota të vlefshme e të pavlefshme për kandidatët për kryetar” pika (i) bëhet si më poshtë:

“Kryetari dhe anëtarët e tjerë të KQV-së numërojnë votat e pavlefshme për kandidatët për kryetar dhe i shënojnë ato në procesverbal dhe në tabelën e rezultateve. Pas kësaj numërojnë votat e vlefshme që ka marrë çdo kandidat për kryetar dhe i shënojnë ato në procesverbal dhe në tabelën e rezultateve. Numri i votave të vlefshme për kandidatët për kryetar duhet të jetë i njëjtë me shumën e votave të vlefshme që ka marrë secili nga kandidatët për kryetar.”.

2. Në nenin 22 “vota të vlefshme e të pavlefshme për listat shumemërore” pika (i) bëhet si më poshtë:

“Kryetari dhe anëtarët e tjerë të KQV-së numërojnë votat e pavlefshme për listat shumemërore dhe i shënojnë ato në procesverbal dhe në tabelën e rezultateve. Pas kësaj numërojnë votat e vlefshme që ka marrë çdo listë shumemërore dhe i shënojnë në procesverbal dhe në tabelen e rezultateve. Numri i votave të vlefshme për listat shumemërore duhet të jetë i njëjtë me shumën e votave të vlefshme që ka marrë secila nga listat shumemërore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**VENDIM**
**Nr.78, datë 17.9.2003**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN "PËR MËNYRËN E ZBATIMIT TË EKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE MBI SHUMAT E LLOGARIVE NË BANKA" MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË NR.43, DATË 11.6.2003**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike, në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Në nenin 6 me titull "Procedura për pezullimin e ekzekutimit të kërkesës/urdhrit", të udhëzimit "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka", të miratojë ndryshimet si vijojnë:

a) Pika 6.1. bëhet: "Pezullimi i kërkesës/urdhrit për vënien e sekuestros bëhet vetëm kundrejt paraqitjes së vendimit të gjykatës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, në përputhje me kriteret e caktuara në nenet 206, 471, 479 dhe 615 të Kodit të Procedurës Civile.".

b) Në pikat 6.2 dhe 6.3 shprehja "pezullimin e gjykimit" zëvendësohet me shprehjen "pezullimin e ekzekutimit të vendimit".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Shkëlqim Cani**

## UDHËZIM

## PËR MËNYRËN E ZBATIMIT TË EKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE MBI SHUMAT E LLOGARIVE NË BANKA

Në mbështetje të nenit 600 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë nxjerr udhëzimin me këtë përmbajtje:

### Neni 1
### Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrës së ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankat e nivelit të dytë, në bazë të titujve ekzekutivë të përcaktuar në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 2
### Përkufizime

Sa herë që përdoren në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

"Bankë"- personin juridik që kryen veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë.

"Debitor" - çdo klient të bankës, që ka pranë saj llogari në emër të tij dhe kundrejt të cilit është lëshuar një kërkesë për vënie sekuestro nga ana e përmbaruesit gjyqësor.

"Llogari" – çdo llogari që përdoret nga klienti debitor në marrëdhëniet me bankën dhe që mund të përdoret për kryerje pagesash në ngarkim të debitorit, llogari rrjedhëse, krediti, depozitë, llogari buxhetore etj.

"Vënie sekuestro"- bllokimin e përkohshëm të shumave në llogari, me qëllim sigurimin e padisë, në përputhje me nenin 206 të Kodit të Procedurës Civile

dhe/ose

nxjerrjen e shumave nga llogaritë dhe kalimin e tyre në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor, në zbatim të neneve 510 dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile.

### Neni 3
### Detyrimi i bankave për të bllokuar llogaritë dhe për të informuar zyrën e përmbarimit

3.1 Në zbatim të neneve 593 dhe 594 të Kodit të Procedurës Civile, zyra e përmbarimit ka të drejtë të kërkojë të informohet dhe të urdhërojë bllokimin e llogarive të debitorit në të gjitha bankat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Kërkesa/urdhri për informim dhe bllokimin e llogarisë paraqitet në formën zyrtare dhe duhet të përmbajë minimalisht:

a) Të dhëna të sakta për identifikimin e klientit:

- emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen dhe adresën e banimit (për individët);
- emërtimin dhe numrin e vendimit të regjistrimit në regjistrin tregtar (për personat fizikë dhe për shoqëritë tregtare);
- emërtimin, si dhe numrin e aktit përkatës për njohjen e personalitetit juridik (për personat e tjerë juridikë).

b) Shumën maksimale të detyrimit për t'u paguar.

c) Afatin e vlefshmërisë për bllokimin e llogarisë.

3.3 Banka është e detyruar, menjëherë, por jo me vonë se 10 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës/urdhrit:

a) të informojë me shkrim zyrën e përmbarimit dhe të bllokojë llogarinë e debitorit deri në shumën e kërkuar;

b) të informojë me shkrim zyrën e përmbarimit për rastet kur klientët nuk kanë llogari pranë saj.

3.4 Në zbatim të pikës 3.2 të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit nxjerr formën standarde të urdhrit të bllokimit, një kopje e të cilës mund t'i dërgohet bankave për dijeni paraprakisht.

Neni 4

**Kërkesat që duhen plotësuar për vënien e sekuestros**

4.1 Në zbatim të nenit 527 dhe të nenit 594 të Kodit të Procedurës Civile, banka vë sekuestron mbi llogarinë e debitorit, deri në masën e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, kundrejt paraqitjes nga zyra e përmbarimit të këtyre dokumenteve:

a) Kërkesa/urdhri i zyrës së përmbarimit për vendosjen e masës së sekuestros, me të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit dhe destinacionin e shumës së sekuestruar, dhe që duhet të përmbajë:

- të dhënat për identifikimin e debitorit, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën (a) të pikës 3.2 të këtij udhëzimi;
- shumën e saktë të detyrimit;
- të dhënat e sakta për emërtimin, numrin e llogarisë dhe bankën për kalimin e shumës së sekuestruar;
- radhën e preferimit, në zbatim të nenit 605 të Kodit Civil.

Në zbatim të kësaj pike, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit nxjerr formën standarde të urdhrit të sekuestrimit, një kopje e të cilës mund t'u dërgohet bankave për dijeni paraprakisht.

b) Vendimi gjyqësor, si dhe çdo akt tjetër, i cili në zbatim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile konsiderohet titull ekzekutiv.

c) Dokumenti që vërteton lajmërimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit dhe për marrjen dijeni nga ana e tij.

4.2 Dokumentet që i dërgohen bankës janë, sipas rastit, origjinale ose të noterizuara, ose të vërtetuara "njësia me origjinalin" nga sekretaria e gjykatës ose fotokopje të vërtetuara me vulën e zyrës së përmbarimit.

4.3 Kërkesa/urdhri për vënie në sekuestro mund të bëhet edhe pa zbatuar nenin 3 të këtij udhëzimi, në rastet kur zyra e përmbarimit ka dijeni të plotë për ekzistencën e llogarive të debitorit dhe nuk e gjykon të nevojshme marrjen e informacionit.

Neni 5

**Procedura e vënies së sekuestros**

5.1 Banka kontrollon dokumentacionin e paraqitur dhe në rast se konstaton mangësi, në formë ose në përmbajtje, praktika i kthehet zyrtarisht zyrës së përmbarimit me vërejtjet e konstatuara, jo më vonë se tri ditëpune nga dita e mbërritjes së tyre në bankë, ndërsa llogaria e debitorit mbahet e bllokuar edhe 10 ditë kalendarike të tjera nga dita e nisjes së përgjigjes, në pritje të rregullimit të mangësive nga zyra e përmbarimit. Në mungesë të përgjigjes nga ana e zyrës së përmbarimit brenda këtij afati, kërkesa/urdhri për sekuestrim konsiderohet se nuk është bërë.

5.2 Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur konsiderohet i rregullt, banka vë sekuestron në llogarinë e debitorit, jo më vonë se tri ditëpune nga dita e marrjes së kërkesës/urdhrit për sekuestro.

5.3 Vënia e sekuestros dhe/ose bllokimi i llogarisë së debitorit nuk pezullon pagimin e kredive që, sipas nenit 605 të Kodit Civil, paguhen me preferim ndaj kërkesës/urdhrit për sekuestro. Kur shuma e llogarive nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e paraqitura për ekzekutim, banka njofton përmbaruesin gjyqësor, i cili respekton radhën e preferimit që përcaktohet në nenin 605 të Kodit Civil.

5.4 Në rastet kur shuma e disponueshme në llogari në ditën e kryerjes së veprimeve, në

përputhje me pikën 5.2 të këtij neni, nuk është e mjaftueshme për të plotësuar të gjithë shumën e detyrimit, veprohet për vënien e sekuestros pjesore, deri në shumën e disponueshme në llogari.

5.5 Me vënien e sekuestros pjesore në llogari, praktika konsiderohet e mbyllur për bankën dhe informohet zyra e përmbarimit, sipas rastit, zyrtarisht ose me kreditimin e llogarisë së saj.

5.6 Zyra e përmbarimit ka të drejtë të rikërkojë vënien në sekuestro për praktikat e kthyera me të njëjtën bankë ose me banka të tjera, duke e nisur praktikën nga e para, deri në përmbushjen e plotë të detyrimit, duke zbatuar të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 4 të këtij udhëzimi.

5.7 Kur banka është në pamundësi për vënien e sekuestros në afatin e parashikuar në pikën 5.2 të këtij neni, tërësisht ose pjesërisht, për mungesë gjendjeje ose për shkak preferimi në zbatim të nenit 605 të Kodit Civil, ajo e kthen praktikën pa veprim dhe njofton zyrën e përmbarimit, jo më vonë se dy ditëpune, pas mbarimit të afatit treditor të përcaktuar në pikën 5.2 të këtij neni.

Neni 6
**Procedura për pezullimin e ekzekutimit të kërkesës/urdhrit**

6.1 Pezullimi i kërkesës/urdhrit për vënien e sekuestros bëhet vetëm kundrejt paraqitjes së vendimit të gjykatës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, në përputhje me kriteret e caktuara në nenet 206, 471, 479 dhe 615 të Kodit të Procedurës Civile.

6.2 Vendimi për pezullimin e ekzekutimit të vendimit mund të paraqitet në bankë nga zyra e përmbarimit ose nga debitori ose përfaqësuesi i autorizuar i tij.

6.3 Me marrjen e vendimit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nga debitori ose nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, banka njofton menjëherë zyrën e përmbarimit, por jo më vonë se tri ditëpune nga marrja e tij.

6.4 Pezullimi nuk ka pasojë heqjen e masës së bllokimit sipas kërkesës /urdhrit të zyrës së përmbarimit, në kuptimin e nenit 3 të këtij udhëzimi.

6.5 Afati për pezullimin e urdhrit dhe bllokimi i llogarisë vazhdon deri në përfundimin e procesit të rigjykimit nga gjykata.

Neni 7
**Verifikimi i dokumentacionit bankar nga përmbaruesi gjyqësor**

7.1 Në kuptim të nenit 598 të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të verifikojë në vend dokumentacionin bankar në prani të punonjësit të ngarkuar nga administratorët e bankës, kur ai ka bazë të dyshojë se banka:

- nuk ekzekuton pa arsye detyrimin tërësisht ose pjesërisht;
- shkel afatet e ekzekutimit;
- nuk respekton radhën e preferimit.

7.2 Verifikimi i kryer në kuptimin e këtij neni dokumentohet me procesverbalin e rastit, një ekzemplar i të cilit mbetet në bankë.

Neni 8
**Dispozita të fundit**

8.1 Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjitha bankat dhe degët e bankave në Republikën e Shqipërisë.

8.2 Të gjitha bankat dhe degët e bankave, subjekte të këtij udhëzimi, detyrohen të afishojnë këtë udhëzim në sportelet e tyre.

8.3 Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive e depozitave në banka", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.39, datë 31.3.1999, shfuqizohet.

8.4 Ky udhëzim u miratua me vendimin nr.43, datë 11.6.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare .

KRYETARI
**Shkëlqim Cani**

## SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për ndërtimin e Aeroportit të Kukësit dhe të rrugëve të reja.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil.

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohen dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit**

## Qarku KUKES
## Komuna : Bicaj
### Fshati : Nange

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE AEROPORTIT TE KUKESIT

*Lloji i pasurise se patundshme . **Toke bujqesore Nr.1-112***

| 1 | | 2 | | 3 | 4 | | | 5 | | | 6 | | | 7 | | 8 | | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Pronar | | | | Toka Bujqesore | | | Truall | | | Objekte | | | Dru Frutore | | Kulturat Bujqesore | | | |
| Nr. | Emer | Atesi | Mbiemer | Numri i pasurise | Siperfaqe (m2) | Cmimi i tokes bujq (lek/m2) | Vlera (lek) | Sip (m2) | Cmimi i Truallit (lek/m2) | Vlera (Lek) | Sip (m2) | Cmimi i objekteve (lek/m2) | Vlera (Lek) | Cope | Vlera (leke) | Cmimi (lek/m2) | Vlera (lek) | Totali (lek) | Shenime |
| 1 | Shefqet | | Doci | | 1548 | 600 | 928800 | | | | | | | | | 16 | 24768 | 953568 | Proces Rregjistrimi |
| 2 | Shefki | | Doci | | 473 | 600 | 283800 | | | | | | | | | 16 | 7568 | 291368 | Proces Rregjistrimi |
| 3 | Shefki | | Doci | | 1505 | 600 | 903000 | | | | | | | | | 16 | 24080 | 927080 | Proces Rregjistrimi |
| 4 | Vebi | | Pepa | | 990 | 600 | 594000 | | | | | | | | | 16 | 15840 | 609840 | Proces Rregjistrimi |
| 5 | Shkelqim | | Pepa | | 210 | 600 | 126000 | | | | | | | | | 16 | 3360 | 129360 | Proces Rregjistrimi |
| 6 | Xhelil | | Shehu | | 5000 | 600 | 3000000 | | | | | | | | | 16 | 80000 | 3080000 | Konflikt |
| 7 | Tahir | | Gashi | | 215 | 600 | 129000 | | | | | | | | | 16 | 3440 | 132440 | Proces Rregjistrimi |
| 8 | Bajram | | Onuzi | | 180 | 600 | 108000 | | | | | | | | | 16 | 2880 | 110880 | Konflikt |
| 9 | Muhamet | | Onuzi | | 462.5 | 600 | 277500 | | | | | | | | | 16 | 7400 | 284900 | Konflikt |
| 10 | Asllan | | Onuzi | | 5225 | 600 | 3135000 | 300 | 1000 | 300000 | 209 | 24236 | 5065324 | 374 | 595200 | 16 | 83600 | 9179124 | Proces Rregjistrimi |
| 11 | Nehat | | Shehu | | 1360 | 600 | 816000 | | | | | | | | | 16 | 21760 | 837760 | Proces Rregjistrimi |
| 12 | Bajram | | Hereni | | 1144 | 600 | 686400 | | | | | | | | | 16 | 18304 | 704704 | Proces Rregjistrimi |
| 13 | Safet | | Hereni | | 728 | 600 | 436800 | | | | | | | | | 16 | 11648 | 448448 | Proces Rregjistrimi |
| 14 | Bedri | | Hereni | | 572 | 600 | 343200 | | | | | | | | | 16 | 9152 | 352352 | Proces Rregjistrimi |
| 15 | Shahin | | Hereni | | 468 | 600 | 280800 | | | | | | | | | 16 | 7488 | 288288 | Konflikt |
| 16 | Halil | | Hereni | | 676 | 600 | 405600 | | | | | | | | | 16 | 10816 | 416416 | Proces Rregjistrimi |
| 17 | Zeqir | | Hereni | | 676 | 600 | 405600 | | | | | | | | | 16 | 10816 | 416416 | Proces Rregjistrimi |
| 18 | Rexhep | | Hereni | | 140 | 600 | 84000 | | | | | | | | | 16 | 2240 | 86240 | Proces Rregjistrimi |
| 19 | Hysni | | Onuzi | | 600 | 600 | 360000 | | | | | | | | | 16 | 9600 | 369600 | Proces Rregjistrimi |
| 20 | Beqir | | Onuzi | | 875 | 600 | 525000 | | | | | | | | | 16 | 14000 | 539000 | Proces Rregjistrimi |
| 21 | Bajram | | Onuzi | | 528 | 600 | 316800 | | | | | | | | | 16 | 8448 | 325248 | Proces Rregjistrimi |
| 22 | Haxhi | | Onuzi | | 114 | 600 | 68400 | | | | | | | | | 16 | 1824 | 70224 | Proces Rregjistrimi |
| 23 | Ilir | | Onuzi | | 69 | 600 | 41400 | | | | | | | | | 16 | 1104 | 42504 | Proces Rregjistrimi |
| 24 | Rahim | | Onuzi | | 1053 | 600 | 631800 | | | | | | | | | 16 | 16848 | 648648 | Konflikt |
| 25 | Shefqet | | Onuzi | | 836 | 600 | 501600 | | | | | | | | | 16 | 13376 | 514976 | Proces Rregjistrimi |
| 26 | Sadik | | Onuzi | | 608 | 600 | 364800 | | | | | | | | | 16 | 9728 | 374528 | Proces Rregjistrimi |
| 27 | Afrim | | Onuzi | | 380 | 600 | 228000 | | | | | | | | | 16 | 6080 | 234080 | Proces Rregjistrimi |
| 28 | Enver | | Onuzi | | 950 | 600 | 570000 | | | | | | | | | 16 | 15200 | 585200 | Proces Rregjistrimi |
| 29 | Bashkim | | Onuzi | | 992 | 600 | 595200 | | | | | | | | | 16 | 15872 | 611072 | Proces Rregjistrimi |
| 30 | Shuaip | | Onuzi | | 416 | 600 | 249600 | | | | | | | | | 16 | 6656 | 256256 | Proces Rregjistrimi |
| 31 | Brahim | | Onuzi | | 81 | 600 | 48600 | | | | | | | | | 16 | 1296 | 49896 | Proces Rregjistrimi |
| 32 | Konflikt | | | | 1800 | 600 | 1080000 | | | | | | | | | 16 | 28800 | 1108800 | Proces Rregjistrimi |
| 33 | Muharrem | | Shehu | | 164 | 600 | 98400 | | | | | | | | | 16 | 2624 | 101024 | Proces Rregjistrimi |
| 34 | Konflikt | | | | 1845 | 600 | 1107000 | | | | | | | | | 16 | 29520 | 1136520 | Proces Rregjistrimi |
| 35 | Konflikt | | | | 533 | 600 | 319800 | | | | | | | | | 16 | 8528 | 328328 | Proces Rregjistrimi |
| 36 | Konflikt | | | | 1148 | 600 | 688800 | | | | | | | | | 16 | 18368 | 707168 | Proces Rregjistrimi |
| 37 | Konflikt | | | | 2021 | 600 | 1212600 | | | | | | | | | 16 | 32336 | 1244936 | Konflikt |
| 38 | Murat | | Shehu | | 1475 | 600 | 885000 | | | | | | | | | 16 | 23600 | 908600 | Proces Rregjistrimi |
| 39 | Refat | | Shehu | | 640 | 600 | 384000 | | | | | | | | | 16 | 10240 | 394240 | Proces Rregjistrimi |
| 40 | Muharrem | | Shehu | | 1184 | 600 | 710400 | | | | | | | | | 16 | 18944 | 729344 | Proces Rregjistrimi |
| 41 | Safet | | Shehu | | 960 | 600 | 576000 | | | | | | | | | 16 | 15360 | 591360 | Proces Rregjistrimi |
| 42 | Myftar | | Shehu | | 2268 | 600 | 1360800 | | | | | | | | | 16 | 36288 | 1397088 | Proces Rregjistrimi |
| 43 | Jashar | | Shehu | | 1288 | 600 | 772800 | | | | | | | | | 16 | 20608 | 793408 | Proces Rregjistrimi |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

## Qarku KUKES

## Komuna : Bicaj

**Fshati : Nange**

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE AEROPORTIT TE KUKESIT

*Lloji i pasurise se patundshme : **Toke bujqesore Nr.1-112***

| 1 | 2 | | | 3 | 4 | | | 5 | | | 6 | | | 7 | | 8 | | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Pronar | | | | Toka Bujqesore | | | Truall | | | Objekte | | | Dru Frutore | | Kulturat Bujqesore | | | |
| Nr. | Emer | Atesi | Mbiemer | Numri i pasurise | Siperfaqe (m2) | Cmimi i tokes bujq (lek/m2) | Vlera (lek) | Sip (m2) | Cmimi i Truallit (lek/m2) | Vlera (Lek) | Sip (m2) | Cmimi i objekteve (lek/m2) | Vlera (Lek) | Cope | Vlera (leke) | Cmimi (lek/m2) | Vlera (lek) | Totali (lek) | Shenime |
| 44 | Naim | | Shehu | | 1316 | 600 | 789600 | | | | | | | | | 16 | 21056 | 810656 | Proces Rregjistrimi |
| 45 | Alush | | Shehu | | 2619 | 600 | 1571400 | | | | | | | | | 16 | 41904 | 1613304 | Proces Rregjistrimi |
| 46 | Haxhi | | Shehu | | 969 | 600 | 581400 | | | | | | | | | 16 | 15504 | 596904 | Proces Rregjistrimi |
| 47 | Izmir | | Shehu | | 969 | 600 | 581400 | | | | | | | | | 16 | 15504 | 596904 | Proces Rregjistrimi |
| 48 | Ylber | | Shehu | | 1020 | 600 | 612000 | | | | | | | | | 16 | 16320 | 628320 | Proces Rregjistrimi |
| 49 | Besim | | Shehu | | 1326 | 600 | 795600 | | | | | | | | | 16 | 21216 | 816816 | Proces Rregjistrimi |
| 50 | Veli | | Gashi | | 1716 | 600 | 1029600 | | | | | | | | | 16 | 27456 | 1057056 | Proces Rregjistrimi |
| 51 | Shaqir | | Gashi | | 938 | 600 | 562800 | | | | | | | | | 16 | 15008 | 577808 | Proces Rregjistrimi |
| 52 | Halil | | Gashi | | 1072 | 600 | 643200 | | | | | | | | | 16 | 17152 | 660352 | Proces Rregjistrimi |
| 53 | Idriz | | Gashi | | 1273 | 600 | 763800 | | | | | | | | | 16 | 20368 | 784168 | Proces Rregjistrimi |
| 54 | Naim | | Gashi | | 675 | 600 | 405000 | | | | | | | | | 16 | 10800 | 415800 | Proces Rregjistrimi |
| 55 | Vesel | | Gashi | | 652.5 | 600 | 391500 | | | | | | | | | 16 | 10440 | 401940 | Proces Rregjistrimi |
| 56 | Rakip | | Gashi | | 652.5 | 600 | 391500 | | | | | | | | | 16 | 10440 | 401940 | Proces Rregjistrimi |
| 57 | Zenel | | Gashi | | 484 | 600 | 290400 | | | | | | | | | 16 | 7744 | 298144 | Proces Rregjistrimi |
| 58 | Enver | | Gashi | | 440 | 600 | 264000 | | | | | | | | | 16 | 7040 | 271040 | Proces Rregjistrimi |
| 59 | Rasim | | Gashi | | 616 | 600 | 369600 | | | | | | | | | 16 | 9856 | 379456 | Proces Rregjistrimi |
| 60 | Medi | | Gashi | | 352 | 600 | 211200 | | | | | | | | | 16 | 5632 | 216832 | Proces Rregjistrimi |
| 61 | Xhezair | | Gashi | | 1166 | 600 | 699600 | | | | | | | | | 16 | 18656 | 718256 | Proces Rregjistrimi |
| 62 | Shaqir | | Gashi | | 729 | 600 | 437400 | | | | | | | | | 16 | 11664 | 449064 | Konflikt |
| 63 | Gani | | Gashi | | 1456 | 600 | 873600 | | | | | | | | | 16 | 23296 | 896896 | Konflikt |
| 64 | Sul | | Gashi | | 725 | 600 | 435000 | | | | | | | | | 16 | 11600 | 446600 | Konflikt |
| 65 | Muharrem | | Gashi | | 1200 | 600 | 720000 | | | | | | | | | 16 | 19200 | 739200 | Konflikt |
| 66 | Rexh | | Gashi | | 1152 | 600 | 691200 | | | | | | | | | 16 | 18432 | 709632 | Proces Rregjistrimi |
| 67 | Nazim | | Gashi | | 1152 | 600 | 691200 | | | | | | | | | 16 | 18432 | 709632 | Proces Rregjistrimi |
| 68 | Hashim | | Gashi | | 1397.5 | 600 | 838500 | | | | | | | | | 16 | 22360 | 860860 | Proces Rregjistrimi |
| 69 | Tahir | | Gashi | | 1290 | 600 | 774000 | | | | | | | | | 16 | 20640 | 794640 | Proces Rregjistrimi |
| 70 | Ismet | | Shehu | | 1440 | 600 | 864000 | | | | | | | | | 16 | 23040 | 887040 | Proces Rregjistrimi |
| 71 | Naim | | Shehu | | 7000 | 600 | 4200000 | | | | | | | | | 16 | 112000 | 4312000 | Proces Rregjistrimi |
| 72 | Xhelal | | Pepa | | 1431 | 600 | 858600 | | | | | | | | | 16 | 22896 | 881496 | Proces Rregjistrimi |
| 73 | Qemal | | Doci | | 2030 | 600 | 1218000 | | | | | | | | | 16 | 32480 | 1250480 | Proces Rregjistrimi |
| 74 | Selman | | Shehu | | 297 | 600 | 178200 | | | | | | | | | 16 | 4752 | 182952 | Proces Rregjistrimi |
| 75 | Azem | | Shehu | | 363 | 600 | 217800 | | | | | | | | | 16 | 5808 | 223608 | Proces Rregjistrimi |
| 76 | Xhelil | | Shehu | | 154 | 600 | 92400 | | | | | | | | | 16 | 2464 | 94864 | Proces Rregjistrimi |
| 77 | Selman | | Shehu | | 132 | 600 | 79200 | | | | | | | | | 16 | 2112 | 81312 | Proces Rregjistrimi |
| 78 | Ferit | | Shehu | | 297 | 600 | 178200 | | | | | | | | | 16 | 4752 | 182952 | Proces Rregjistrimi |
| 79 | Shuaip | | Shehu | | 364 | 600 | 218400 | | | | | | | | | 16 | 5824 | 224224 | Proces Rregjistrimi |
| 80 | Beqir | | Onuzi | | 714 | 600 | 428400 | | | | | | | | | 16 | 11424 | 439824 | Proces Rregjistrimi |
| 81 | Ahmet | | Tershalla | | 990 | 600 | 594000 | | | | | | | | | 16 | 15840 | 609840 | Proces Rregjistrimi |
| 82 | Qazim | | Tershalla | | 1196 | 600 | 717600 | | | | | | | | | 16 | 19136 | 736736 | Proces Rregjistrimi |
| 83 | Jonuz | | Tershalla | | 672 | 600 | 403200 | | | | | | | | | 16 | 10752 | 413952 | Proces Rregjistrimi |
| 84 | Hajredin | | Tershalla | | 696 | 600 | 417600 | | | | | | | | | 16 | 11136 | 428736 | Proces Rregjistrimi |
| 85 | Hetem | | Tershalla | | 1428 | 600 | 856800 | | | | | | | | | 16 | 22848 | 879648 | Proces Rregjistrimi |
| 86 | Hajredin | | Tershalla | | 20 | 600 | 12000 | | | | | | | | | 16 | 320 | 12320 | Proces Rregjistrimi |

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit**

## Qarku KUKES
## Komuna : Bicaj
### Fshati : Nange

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE AEROPORTIT TE KUKESIT

*Lloji i pasurise se paluajtshme* ***Toke bujqesore Nr.1-112***

| 1 | 2 | | | 3 | 4 | | | 5 | | | 6 | | | 7 | | 8 | | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Pronar | | | | Toka Bujqesore | | | Truall | | | Objekte | | | Dru Frutore | | Kulturat Bujqesore | | | |
| Nr | Emer | Atesi | Mbiemer | Numri i pasurise | Siperfaqe (m2) | Cmimi i tokes bujq (lek/m2) | Vlera (lek) | Sip (m2) | Cmimi i Truallit (lek/m2) | Vlera (Lek) | Sip (m2) | Cmimi i objekteve (lek/m2) | Vlera (Lek) | Cope | Vlera (leke) | Cmimi (lek/m2) | Vlera (lek) | Totali (lek) | Shenime |
| 87 | Jonuz | | Tershalla | | 144 | 600 | 86400 | | | | | | | | | 16 | 2304 | 88704 | Proces Rregjistrimi |
| 88 | Qazim | | Tershalla | | 690 | 600 | 414000 | | | | | | | | | 16 | 11040 | 425040 | Proces Rregjistrimi |
| 89 | Ahmet | | Tershalla | | 1125 | 600 | 675000 | | | | | | | | | 16 | 18000 | 693000 | Proces Rregjistrimi |
| 90 | Beqir | | Onuzi | | 1365 | 600 | 819000 | | | | | | | | | 16 | 21840 | 840840 | Proces Rregjistrimi |
| 91 | Shuaip | | Onuzi | | 936 | 600 | 561600 | | | | | | | | | 16 | 14976 | 576576 | Proces Rregjistrimi |
| 92 | Ferit | | Shehu | | 1134 | 600 | 680400 | | | | | | | | | 16 | 18144 | 698544 | Proces Rregjistrimi |
| 93 | Selman | | Shehu | | 576 | 600 | 345600 | | | | | | | | | 16 | 9216 | 354816 | Proces Rregjistrimi |
| 94 | Xhelil | | Shehu | | 672 | 600 | 403200 | | | | | | | | | 16 | 10752 | 413952 | Proces Rregjistrimi |
| 95 | Azem | | Shehu | | 1617 | 600 | 970200 | | | | | | | | | 16 | 25872 | 996072 | Proces Rregjistrimi |
| 96 | Selman | | Shehu | | 1377 | 600 | 826200 | | | | | | | | | 16 | 22032 | 848232 | Proces Rregjistrimi |
| 97 | Kadri | | Shehu | | 7950 | 600 | 4770000 | | | | | | | | | 16 | 127200 | 4897200 | Proces Rregjistrimi |
| 98 | Qemal | | Doci | | 572 | 600 | 343200 | | | | | | | | | 16 | 9152 | 352352 | Proces Rregjistrimi |
| 99 | Shefki | | Onuzi | | 1656 | 600 | 993600 | | | | | | | | | 16 | 26496 | 1020096 | Proces Rregjistrimi |
| 100 | Zgjidhje pronesie | | | | 3300 | 600 | 1980000 | | | | | | | | | 16 | 52800 | 2032800 | Proces Rregjistrimi |
| 101 | Ismail | | Shehu | | 885 | 600 | 531000 | | | | | | | | | 16 | 14160 | 545160 | Proces Rregjistrimi |
| 102 | Ismail | | Shehu | | 1122 | 600 | 673200 | | | | | | | | | 16 | 17952 | 691152 | Proces Rregjistrimi |
| 103 | Nihat | | Shehu | | 2109 | 600 | 1265400 | | | | | | | | | 16 | 33744 | 1299144 | Proces Rregjistrimi |
| 104 | Selman | | Shehu | | 2201 | 600 | 1320600 | | | | | | | | | 16 | 35216 | 1355816 | Proces Rregjistrimi |
| 105 | Jashar | | Shehu | | 1360 | 600 | 816000 | | | | | | | | | 16 | 21760 | 837760 | Proces Rregjistrimi |
| 106 | Muharrem | | Shehu | | 957 | 600 | 574200 | | | | | | | | | 16 | 15312 | 589512 | Proces Rregjistrimi |
| 107 | Ali | | Shehu | | 7560 | 600 | 4536000 | | | | | | | | | 16 | 120960 | 4656960 | Proces Rregjistrimi |
| 108 | Ali | | Shehu | | 260 | 600 | 156000 | | | | | | | | | 16 | 4160 | 160160 | Proces Rregjistrimi |
| 109 | Garip | | Shehu | | 1365 | 600 | 819000 | | | | | | | | | 16 | 21840 | 840840 | Proces Rregjistrimi |
| 110 | Kadri | | Shehu | | 1425 | 600 | 855000 | | | | | | | | | 16 | 22800 | 877800 | Proces Rregjistrimi |
| 111 | Zgjidhje pronesie | | | | 10920 | 600 | 6552000 | | | | | | | | | 16 | 174720 | 6726720 | Proces Rregjistrimi |
| 112 | Mal | | Gashi | | 938 | 600 | 562800 | | | | | | | | | 16 | 15008 | 577808 | Proces Rregjistrimi |
| | Shuma | | | | 145198 | | 87118800 | 300 | 1000 | 300000 | 209 | 24236 | 5065324 | 374 | 595200 | | 2323168 | 95402492 | |

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
**Qarku KUKES**
**Komuna : Bicaj**
**Fshati : Nange**

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDRYSHIMIT TE RRUGES

*Lloji i pasurise se patundshme : **Toke bujqesore Nr.1-46***

| 1 | 2 | | | 3 | 4 | | | 5 | | | 6 | | | 7 | | 8 | | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Pronar | | | Toka Bujqesore | | | | Truall | | | Objekte | | | Dru Frutore | | Kulturat Bujqesore | | | |
| Nr | Emer | Atesi | Mbiemer | Numri i pasurise | Siperfaq( m2) | Cmimi i tokes bujq (lek/m2) | Vlera (lek) | Sip (m2) | Cmimi i Truallit (lek/m2) | Vlera (Lek) | Sip (m2) | Cmimi i objekteve (lek/m2) | Vlera (Lek) | Cope | Vlera (leke) | Cmimi (lek/m2) | Vlera (lek) | Totali (lek) | Shenime |
| 1 | Kadri | Abdyl | Shehu | 131/1 | 6550 | 600 | 3930000 | | | | | | | | | 16 | 104800 | 4034800 | Proces Rregjistrimit |
| 2 | Naim | Nuhi | Spahia | 7/9 | 2175 | 600 | 1305000 | | | | | | | | | 16 | 34800 | 1339800 | Proces Rregjistrimit |
| 3 | Hamet | Rasim | Shehu | 7/2 | 475 | 600 | 285000 | | | | | | | | | 16 | 7600 | 292600 | Proces Rregjistrimit |
| 4 | Ferit | Zenel | Shehu | 7/10 | 475 | 600 | 285000 | | | | | | | | | 16 | 7600 | 292600 | Proces Rregjistrimit |
| 5 | Shemsi | Shem | Shehu | 7/11 | 475 | 600 | 285000 | | | | | | | | | 16 | 7600 | 292600 | Proces Rregjistrimit |
| 6 | Azem | Jemin | Shehu | 7/12 | 475 | 600 | 285000 | | | | | | | | | 16 | 7600 | 292600 | Proces Rregjistrimit |
| 7 | Ismail | Fetah | Shehu | 7/16 | 675 | 600 | 405000 | | | | | | | | | 16 | 10800 | 415800 | Proces Rregjistrimit |
| 8 | Shaqir | Fetah | Gashi | 7/18 | 375 | 600 | 225000 | | | | | | | | | 16 | 6000 | 231000 | Proces Rregjistrimit |
| 9 | Korab | Rexhep | Gashi | 7/20/1 | 375 | 600 | 225000 | | | | | | | | | 16 | 6000 | 231000 | Proces Rregjistrimit |
| 10 | Ahmet | Selman | Tershalla | 7/20/2 | 475 | 600 | 285000 | | | | | | | | | 16 | 7600 | 292600 | Proces Rregjistrimit |
| 11 | Myftar | Nuhi | Shehu | 9/21 | 525 | 600 | 315000 | | | | | | | | | 16 | 8400 | 323400 | Proces Rregjistrimit |
| 12 | Xhemali | Jemin | Shehu | 7/29 | 525 | 600 | 315000 | | | | | | | | | 16 | 8400 | 323400 | Proces Rregjistrimit |
| 13 | Jahir | Shem | Shehu | 7/30 | 575 | 600 | 345000 | | | | | | | | | 16 | 9200 | 354200 | Proces Rregjistrimit |
| 14 | Ramiz | Dali | Shehu | 7/31 | 575 | 600 | 345000 | | | | | | | | | 16 | 9200 | 354200 | Proces Rregjistrimit |
| 15 | Ymer | Etem | Bajraktari | 7/34/1 | 250 | 600 | 150000 | | | | | | | | | 16 | 4000 | 154000 | Proces Rregjistrimit |
